



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: AGROEKONOMI

Programi: EKONOMIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se:

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati REMZI RRAHMANI, me titull: **"NDIKIMI I SHPENZIMEVE QEVERITARE NË EKSPORTIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE NË KOSOVË"** ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 03.10.2024 deri me datë 09.10.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Dr. Arben MUSLIU kryetar,
2. Prof. Asco. Dr. Jehona SHKODRA, mentor - anëtare,
3. Prof. Ass. Dr. Prespa YMERI, anëtare

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Asoc. Dr. Jehona Shkodra, përmes e-mail adresës jehona.shkodra@uni-pr.edu

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë!

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Departamenti: AGROEKONOMI

Drejtimi: Ekonomi e Bujqësisë dhe Ushqimit



PUNIM DIPLOME
(Studime Master)

“Ndikimi i shpenzimeve qeveritare në eksportin e produkteve bujqësore
në Kosovë”

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Jehona Shkodra

Kandidate: B.Sc. Remzi Rrahmani

Prishtinë, 2024

ABSTRAKTI

Në këtë studim trajtohet rëndësia e bujqësisë si një sektor kyç për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe sesi shpenzimet qeveritare kanë ndikim të drejtpërdrejtë në punësimin dhe eksportet në këtë sektor. Në Kosovë, bujqësia luan një rol të madh në ekonominë e vendit, duke siguruar të ardhura për një pjesë të madhe të popullsisë rurale dhe duke kontribuar në stabilitetin social dhe ekonomik. Megjithatë, sektori përballlet me sfida të mëdha, përfshirë fragmentimin e tokës, mungesën e investimeve dhe mbështetjes teknike, si dhe varësinë e lartë nga faktorët natyrorë. Në këtë kontekst, politikat dhe shpenzimet qeveritare kanë një rol të rëndësishëm për të përmirësuar produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e sektorit bujqësor.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të vlerësojë ndikimin e shpenzimeve qeveritare në rritjen e punësimit dhe përmirësimin e eksporteve bujqësore. Përmes një analize të të dhënave statistikore dhe literaturës ekzistuese, hulumtimi shqyrton se si mbështetja financiare, përfshirë subvencionet dhe grantet, ndikon në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit dhe si kjo reflektohet në treguesit kryesorë ekonomikë, si punësimi dhe eksportet. Duke analizuar periudha të caktuara kohore dhe duke krahasuar efektet e ndryshme të politikave bujqësore, studimi nxjerr në pah faktorët që ndihmojnë në maksimizimin e efektivitetit të shpenzimeve publike në këtë sektor.

Rezultatet e studimit tregojnë se investimet qeveritare në bujqësi kanë një ndikim të konsiderueshëm në përmirësimin e efikasitetit dhe konkurrueshmërisë së prodhimeve bujqësore, gjë që ka rezultuar në rritjen e eksporteve dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Ndikimi më i madh është vërejtur në zonat rurale, ku investimet në infrastrukturë, mekanizim dhe mbështetje teknike kanë krijuar kushte më të mira për prodhim dhe tregti. Për më tepër, studimi identifikon se për të arritur rezultate të qëndrueshme, është e nevojshme që shpenzimet qeveritare të orientohen në mënyrë strategjike, duke u fokusuar në sektorët me potencial të lartë për rritje dhe zhvillim. Në përfundim, studimi sugjeron që përmirësimi i politikave bujqësore dhe rritja e investimeve publike mund të shërbejnë si shtytës kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së Kosovës. Shpenzimet qeveritare, të kombinuara me politika mbështetëse për zhvillimin rural dhe nxitjen e inovacionit, janë çelësi për përmirësimin e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor dhe për të krijuar një mjedis më të favorshëm për eksportet bujqësore. Kjo qasje do të mundësojë jo vetëm rritjen e produktivitetit, por edhe përmirësimin e kushteve të jetesës për popullsinë rurale dhe rritjen e stabilitetit ekonomik të vendit në afat të gjatë.